

VENDIM
Nr. 23, datë 29.4.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska	anëtare e	“	”
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“	”
Fiona Papajorgji	anëtare e	“	”
Altin Binaj	anëtar i	“	”
Përparim Kalo	anëtar i	“	”
Sonila Bejtja	anëtare e	“	”

me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.4.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 16 (S) 2018 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “REPLEK FARM” LTD.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “ALKOMEDICA” sh.p.k.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2017-2385 (164), datë 7.12.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” të Kushtetutës; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkeses, shoqërisë “Replek Farm” Ltd, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, shoqërisë “Alkomedica” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, shoqëria “Replek Farm” Ltd, është person juridik i huaj që ushtron aktivitetin në fushën e prodhimeve farmaceutike dhe kimike, sipas legjislacionit maqedonas. Subjekti i interesuar, shoqëria “Alkomedica” sh.p.k., ushtron aktivitetin sipas legjislacionit shqiptar në fushën e tregimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të aparaturave e pajisjeve mjekësore.

2. Midis kërkeses dhe subjektit të interesuar, në datën 11.12.2015, është lidhur në Shkup të Maqedonisë së Veriut, përpara noterit, një kontratë 2-vjeçare e titulluar “Kontratë Distribucioni” (*Kontrata*), sipas së cilës subjektit të interesuar i jepej e drejta e importimit, marketingut, promocionit dhe shitjes së produkteve të saj farmaceutike në territorin shqiptar.

3. Mes palëve ka lindur konflikt, në lidhje me likuidimin e faturave të lëshuara nga kërkesja në shumën prej 147.993 eurosh. Prandaj, në datën 7.10.2016, palët kanë nënshkruar një aktmarrëveshje të titulluar “Pajtim Jashtëgjyqësor” (*Aktmarrëveshja*), në të cilën është përcaktuar se detyrimi do të shlyhej nga debitori me tri kështe brenda datës 29.12.2016. Sipas neneve 4 dhe 5, të kësaj Aktmarrëveshjeje, kjo e fundit përbënte titull ekzekutiv dhe debitori tërhoqej nga e drejta për ta kundërshtuar atë. Por, edhe pas nënshkrimit të këtij akti pajtimi jashtëgjyqësor, kërkesja ka pretenduar se detyrimi nuk është përmbushur nga subjekti i interesuar brenda afatit, ndaj në këto

rrethana ajo i është drejtuar juridiksionit gjyqësor, duke kërkuar përmbushjen e këtij detyrimi, sipas Kontratës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5203, datë 9.6.2017, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi, sipas saj, bazuar në nenin 12 të Kontratës, mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ekonomike Ndërkombëtare në Gjenevë, Zvicër, duke zbatuar ligjin material maqedonas. Në referencë të nenit 73, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10484, datë 2.6.2011, “Për të drejtën ndërkombëtare private”, (*ligji nr. 10428/2011*), gjykata e faktit ka vlerësuar se kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin e gjykatave shqiptare, kjo marrëveshje duhet të jetë në formë të shkruar, çka nuk është përmbushur në rastin konkret.

5. Kërkuesja ka ushtruar ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. 5203, datë 9.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për vazhdimin e gjykimit. Ndërsa, subjekti i interesuar ka paraqitur kundërankim në Gjykatën e Lartë.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2017-2385 (164), datë 7.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5203, datë 9.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) në datën 6.4.2018. Kolegji i Gjykatës, në datën 6.6.2018, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

8. Me plotësimin e kuorumit të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 22.1.2021, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesja, shoqëria “Replek Farm” Ltd**, ka pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, ajo ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka cenuar:

9.1 *Standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, të parashikuar në nenin 142, pika 1, të Kushtetutës. Sipas kërkueses, vendimi i Gjykatës së Lartë që kundërshtohet nuk përmban një analizë juridiko-ligjore dhe i mungon tërësisht arsyetimi. Gjykata e Lartë ka cituar faktet dhe ligjin e aplikueshëm, por nuk ka bërë një interpretim ligjor të konfliktit, objekt gjykimi, në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve. Edhe pse palët kanë pranuar gjatë gjykimit në shkallë të parë t’ia nënshtrojnë zgjidhjen e konfliktit juridiksionit gjyqësor shqiptar, duke e konsideruar Aktmarrëveshjen si heqje dorë nga arbitrazhi, kjo gjë që nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Lartë.

9.2 *Të drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi duke mos arsyetuar vendimin për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, i ka mohuar kërkueses këtë të drejtë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Gjykata vëren se, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së

kërkesës, llojin e pasojave negative të pësuar, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kërkuesja, si person juridik i huaj, bazuar në nenin 16 të Kushtetutës, ka të njëjtat të drejta e liri themelore të parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, prandaj ajo legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor objekt i këtij ankimi kushtetues individual.

12. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Shterimi i mjetit është kusht si në rastet e kundërshtimit të një vendimi gjyqësor, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, ashtu edhe në rastet e kundërshtimit të një dispozite ligjore/ligji.

13. Në çështjen konkrete rezulton se vendimi i fundit, që ka përmbyllur procesin gjyqësor dhe ka vendosur në mënyrë përfundimtare për pretendimet e kërkuases, është vendimi i Gjykatës së Lartë objekt shqyrtimi. Po ashtu, rezulton se pretendimet në lidhje me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ajo i ka ngritur edhe në rekurs. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuasesja e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Në rastin në shqyrtim, vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka mbyllur procesin gjyqësor në gjykatat e zakonshme, mban datën 7.12.2017, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 6.4.2018, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji. Rrjedhimisht, kërkuasesja legjitimohet *ratione temporis* t’i drejtohet Gjykatës.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuasesja ka ngritur pretendime për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë, pretendime të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues. Pavarësisht se kërkuasesja i ka paraqitur të ndara këto pretendime, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e saj që lidhet me rastet e kontrollit kushtetues të vendimeve gjyqësore, të cilat kanë vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, do t’i analizojë ato të lidhura së bashku (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, të lidhur me të drejtën e aksesit në gjykatë

16. Kërkuasesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e aksesit në gjykatë. Sipas saj, vendimi që kundërshtohet nuk përmban një analizë juridiko-ligjore dhe i mungon tërësisht arsytimi. Gjykata e Lartë ka cituar faktet dhe ligjin e aplikueshëm, por nuk ka bërë një interpretim ligjor të konfliktit, objekt gjykimi, në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të palëve. Për rrjedhojë, kërkuasesja i është cenuar edhe e drejta e aksesit në gjykatë, pasi ajo nuk ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, sipas kërkuases, palët kanë pranuar gjatë gjykimit në shkallë të parë, t’ia nënshtrojnë zgjidhjen e konfliktit juridiksionit gjyqësor shqiptar, duke e konsideruar Aktmarrëveshjen si heqje dorë nga arbitrazhi, gjë e cila nuk është marrë parasysh nga Gjykata e Lartë.

17. Lidhur me standardin e arsytimit, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të

Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Standardi i arsyetimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është edhe e drejta e aksesit në gjykatë. Gjykata është shprehur se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit, në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren, nga aktet e dosjes gjyqësore, se sipas nenit 12 të Kontratës, të nënshkruar midis kërkueses dhe subjektit të interesuar, mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ekonomike Ndërkombëtare në Gjenevë, Zvicër, duke zbatuar ligjin material maqedonas. Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, pasi ka paraqitur rrethanat e çështjes dhe pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuesja dhe në kundër ankim nga subjekti i interesuar, ka vlerësuar se: “nga aktet e paraqitura rezulton se palët kontraktore, në Kontratën e datës 11.12.2015, kanë parashikuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës së Arbitrazhit në Gjenevë, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe njëkohësisht kanë përcaktuar legjislacionin maqedonas si ligj të zbatueshëm (...) Kolegji [i Gjykatës së Lartë] çmon se gjykata ka arsyetuar drejt në lidhje me përcaktimin e juridiksionit për Kontratën e lidhur mes palëve, e cila është në pajtim me nenin 45, të ligjit nr. 10428/2011, i cili parashikon: 1. *Kontrata rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët (...)* 2. *Zgjedhja e ligjit duhet të jetë e shprehur ose të rezultojë e qartë nga kushtet e kontratës ose rrethana të tjera të çështjes (...)* Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme dhe nga tërësia e normave që përmban ligji nr. 10428/2011, rezulton se palët kanë të drejtë të përcaktojnë në kontratë jo vetëm ligjin e zbatueshëm (...), por edhe juridiksionin përkatës (...) Sipas nenit 73 të ligjit që parashikon rastet kur juridiksioni është caktuar me marrëveshje: “1. *Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare* 2. *Një marrëveshje e tillë duhet: a) të lidhet me shkrim ose me gojë, por duke u vërtetuar kjo e fundit me shkrim (...)* Kolegji [i Gjykatës së Lartë] vlerëson se juridiksioni i parashikuar në kontratë mund të ndryshohet nga palët, por një marrëveshje e tillë duhet të vërtetohet gjithnjë me shkrim. Për më tepër që në Kontratë palët kanë parashikuar dhe zgjedhur

ligjin e aplikueshëm në zgjidhjen e konflikteve midis tyre, që është ligji maqedonas” (*shih faqet 8–9, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

21. Edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u mbështetur në nenin 12 të Kontratës, si dhe në nenet 45 dhe 73, të ligjit nr. 10428/2011, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Ajo ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se juridiksioni i parashikuar në kontratë edhe mund të ndryshohet nga palët, por një marrëveshje e tillë duhet të vërtetohet gjithmonë me shkrim, në përputhje me nenin 73, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 10428/2011. Sipas saj, në Kontratë palët kanë parashikuar dhe zgjedhur ligjin e aplikueshëm në zgjidhjen e konflikteve midis tyre, që është ligji material maqedonas, prandaj ajo ka arritur në përfundimin se çështja duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi vetë palët me marrëveshje midis tyre kanë parashikuar në Kontratë zgjidhjen e konflikteve nga një gjykatë arbitrazhi (*shih faqet 3–5 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

22. Gjykata vlerëson të theksojë se trajtimi i detajuar i të gjitha elementeve të standardit të arsyetimit të vendimit, si dhe dhënia përgjigje çdo pretendimi të paraqitur nga palët në rekurs, merr rëndësi të veçantë në rastet kur gjykatat e zakonshme vendosin se çështja nuk hyn në juridiksionin e tyre gjyqësor, duke qenë se kjo vendimmarrje e tyre, që nuk e zgjidh çështjen në themel, kufizon aksesin në gjykatë të individit.

23. Nisur nga sa më sipër, Gjykata konstaton se Kolegji i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar në mënyrë të përmbledhur se ndryshimi i juridiksionit të përcaktuar në Kontratë, me marrëveshje të mëvonshme, duhet të rezultonte në formë të shkruar, bazuar në nenin 73, pika 2, të ligjit nr. 10428/2011, prandaj në kushtet kur marrëveshja me shkrim nuk është bërë, ligji i aplikueshëm në rastin konkret është ligji maqedonas, sipas Kontratës.

24. Gjithashtu, Gjykata vëren se sipas nenit 73, pika 3, të ligjit nr. 10428/2011: “gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore”.

25. Në rastin konkret rezulton se subjekti i interesuar (i padituri në gjykimin e themelit), gjatë gjykimit në shkallë të parë, në seancën gjyqësore të datës 18.4.2017, është shprehur: “Për zgjidhjen e kësaj çështjeje është përcaktuar qartë në kontratën e distribucionit që gjykatë kompetente është gjykata e arbitrazhit në Zvicër; për këtë arsye i kërkoj gjykatës kohë për të paraqitur kërkesën për nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor në formën e kërkuar nga ligji dhe të shoqëruar me prova.”. Për pasojë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur ta shtyjë seancën gjyqësore, në mënyrë që t’i jepte kohë përfaqësuesit të subjektit të interesuar për të paraqitur kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Më pas, në seancën gjyqësore të datës 17.5.2017, subjekti i interesuar, në lidhje me këtë çështje, është shprehur: “Heqim dorë nga kërkesa për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, dhe kërkojmë të vazhdojmë gjykimin”. Gjykata e shkallës së parë ka vijuar me shqyrtimin e themelit të çështjes dhe në seancën e datës 9.6.2017, u ka kërkuar palëve të shprehen për juridiksionin. Për këtë kërkesë, kërkuësja ka argumentuar: “Të dyja palët me marrëveshje dhe veprime konkludente kanë pranuar juridiksionin e kësaj gjykate; ky pretendim është ngritur nga pala e paditur e cila hoqi dorë gjatë gjykimit”, ndërsa subjekti i interesuar është shprehur: “Sot e lë në çmim të gjykatës, meqenëse nuk kemi një marrëveshje me shkrim.”.

26. Për sa më sipër dhe nisur nga aktet e dosjes rezulton se kërkuësja e ka ngritur në rekurs pretendimin që gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar zbatimin e kushtit të parashikuar në nenin 73, pika 3, të ligjit nr. 10428/2011. Përveç kësaj, kërkuësja ka pretenduar në rekurs se në rastin konkret kemi të bëjmë me shlyerjen e faturave tatimore të papaguara, të cilat sipas ligjit nr. 46/2014, datë 24.4.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” janë tituj ekzekutivë dhe bazuar në nenin 72, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10428/2011, hyjnë në juridiksionin ekskluziv të gjykatave shqiptare (*faqe 2, e vendimit të Gjykatës së Lartë*).

27. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, edhe pse në arsyetim është shprehur se i është referuar tërësisë së normave që përmban ligji nr. 10428/2011, nuk i ka vlerësuar pretendimet e mësipërme të ngritura nga kërkuësja në shkaqet e rekursit, edhe pse ato kishin rëndësi në përcaktimin e juridiksionit. Konkretisht, ajo nuk ka analizuar nëse veprimet e palëve gjatë gjykimit përmbushin ose jo kriteret e parashikuara në nenin 73, pika 3, të ligjit nr. 10428/2011, ose nëse në çështjen konkrete gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv, sipas nenit 72, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10428/2011. Gjykata konstaton se këto pretendime të kërkuësës, të cilat kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes së juridiksionit, nuk kanë gjetur përgjigje të arsyetuar në vendimin e Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit duhet t’u jepte përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkuësës, në funksion të pasjes së një vendimi gjyqësor të qartë dhe të plotë, në përputhje me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

28. Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson standardet e një vendimi të arsyetuar, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar. Gjithashtu, duke pasur parasysh lidhjen e ngushtë midis standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së aksesit në gjykatë, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se standardi i arsyetimit i zbatuar në këtë rast nga Gjykata e Lartë, sjell ndikim në të drejtën e aksesit të kërkuësës. Gjithsesi, për sa kohë çështja do të kthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, Gjykata nuk do të vijojë me analizën e bazueshmërisë së pretendimit të kërkuësës për cenim të aksesit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2017-2385 (164), datë 7.12.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.4.2021.

Shpallur më 24.5.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtar: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo